27.09.2024

Proçes-Verbal i mbajtur sot më datë 27.09.2024 ora 13:00 min, në sallën e mbledhjeve pranë Bashkisë Cërrik. Në mbledhje marrin pjesë Kryetari i Bashkisë dhe këshilltarët:

1- Besnik Binjaku — 11- Zegjine Dhapa
2- Erona Gjini — 12- Qamil Boja
3- Jetmir Laroshi — 13- Hadire Aslani
4- Zamira Fahriu — 14- Eldon Kumrija
5- Adriatik Belshi — 15- Flutura Hoxholli
6- Adi Sepa — 16- Shyqyri Dhika
7- Burbuqe Qofa — 17- Mandi Ploka
8- Eldon Ibro — 18- Shyqyri Kamami
9- Pranvera Lisi — 19- Anisa Toçi
10- Asqeri Dibraku — 20- Gazmira Frakulli.

Mungojnë: Erinda Vishkulli

Mbledhja kryesohet nga kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Jetmir Laroshi, i cili konstatoi që në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e këshilltarëve dhe këshilli i plotë fuqishëm mund të vendos. Për këtë muaj parashtrohet ky rend-dite:

1- Pr/Vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për bllok-Ndihmë (6%) muaji Gusht."

2- Pr/Vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë. Për periudhën 1-30.08.2024".

3- Pr/Vendim: "Plani Social i Bashkisë Cërrik 2024-2027"

4- Pr/Vendim: "Për miratimin e ndihmës financiare për fëmijët me aftësi ndryshe."

5- Pr/Vendim: "Për miratimin e ndihmës financiare për familjet në nevojë".

6- Pr/Vendim: "Shpërndarjen e fondit për rritjen e pagave, sipas nivelit minimal për vitin 2024"
7- Pr/Vendim: "Për miratimin e kalendarit të konsultimeve publike të buxhetit 2025 dhe PBA 2025-2027"
8- Pr/Vendim: "Rritjen e limitit të përdorimit të të ardhurave për vitin 2024"
9- Pr/Vendim: "Për disa ndryshime, në nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, nëpunësve civil e të punonjësve administrative dhe punonjësve mbështetës të aktiviteteve ndihmëse në Bashkinë Cërrik."
Jashtë rendit të ditës:
1- Pr/Vendim: "Për shtyrjen e afatit të Administratorit të klubit të futbollit Turbina".

Kryesuesi: kush është dakord me rendine ditës dhe ndryshimet në të?
Miratohet rendi i ditës me: 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Abstenim
Pika 1
Znj. Ornela Mehmeti, punonjëse pranë sektorit Social i propozon Këshillit Bashkiak Cërrik, ku ti propozojnë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin Gusht 2024, me 6% e fondit të Bllok - Ndihmës 38 familje me një fond prej 147.340 lekë. Pagesa të kryhet sipas listës emërore që bashkëlidhet këtij projekti.
Pyetje dhe diskutime? S'ka
Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Abstenim

Pika 2
Znj. Ornela Mehmeti propozon për miratim ku të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e Bashkisë Cërrik, për muajin Gusht 2024, 43 (dyzetë e tre) familje me një fond prej 205.057 lekë. Ndarja sipas Njësive Administrative sipas listës përkatëse.
Dhe këtë muaj kemi ardhje të reja.
Pyetje dhe diskutime? S'ka
Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Abstenim.
Pika 3
Znj. Alketa Binjaku, shefe e kabinetit të kryetarit, propozon për miratimin e Planit Social i Bashkisë Cërrik 2024-2027. Znj. Alketa relatoi në lidhje me rifreskimin e Planit Social i cili do të funksionojë për një periudhë 3-vjeçare, për vitet 2024-2027.
Pyetje dhe diskutime:
Znj. Flutura Hoxholli: - Sa punonjës me aftësi të kufizuar keni në Bashki?
Znj. Alketa: Diku te 3-persona.
Znj. Gazmira Frakulli: - A ka kërkesa nga personat me aftësi ndryshe për punë?
Znj. Alketa: - Kërkesat janë shumë të pakta.
Plani social përfshin dhe moshën e tretë.
Znj. Gazmira: - Më vjen mirë që përfshihen dhe moshat e treta që s'kanë fëmijë për përkujdesje.
Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Abstenim

Pika 4

Z. Hekuran Kumria, Drejtor i Financës, i propozon Këshillit të miratojë ndihmën financiare për fëmijët me aftësi ndryshe si më poshtë.

- Rosi Niko Suloj Bashkia Cërrik.

Pagesa të kryhet sipas preventivit bashkëngjitur për çdo ditë të prezencës në shkollë.

Financimi nga buxheti i Bashkisë për vitin 2024 në shumën 21 600 lekë.

Pyetje dhe diskutime? Ska

Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim

Pika 6

Z. Hekuran Kumria: paraqet për miratim për ndihmë financiare për familjet në nevojë si më poshtë:

1- Krenar Faik Plaku 30000 lekë
2- Gezmir Eqrem Beqiri 20000 lekë

Financimi të sigurohet nga buxheti i Bashkisë Cërrik Fondi Rezerv 2024.

Z. Hekuran: Të dyja familjet janë me probleme të rënda financiare dhe shëndetsore.

Pyetje dhe diskutime? Ska

Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim.

Pika 7.

Z. Hekuran Kumria, paraqet për miratim shpërndarjen e fondit si më poshtë:

1- Shpenzime për rritjen e pagave në shumën: Shuma: 8,000,000.00 lekë

2- Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetsore, në shumën: 1,457,776,00 lekë.

Z. Hekuran Sqaroi se me shkresë të Ministrisë Financave nr. 11788 prot. datë 4/09/2024 "Për detajimin e fondeve për rritjen e pagave sipas kufirit minimal për funksionarët e zgjedhur e të miratuar, të Nëpunësve Civile e të Punonjësve Administrativ të Njësive të Vetqeverisjes Vendore" është dërguar fondi në shumën 9,457,776,00 lekë.

Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim.

Pika 8

Z. Hekuran Kumria, Paraqet Kalendarin e konsultimeve Publike për programimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027.

Z. Hekuran Sqaroi: - Këshilli Bashkiak dhe Bashkia: Bashkia Cërrik do të informojë komunitetin mbi të dhënat për zbatimin e buxhetit të bashkisë 6-mujori i parë 2024, për secilin program buxhetor të PBA 2025-2027, draft Buxheti për vitin 2025, shërbimet e ofruara nga bashkia dhe draft paketa Fiskale 2025.

Qëllimi: Kërkohet opinioni i qytetarëve dhe grupeve të interesit, përfshirë grupet vulnerabël, për draft projektet e PBA 2025-2027, draft Buxheti 2025, cilat janë shërbimet që duhet të përmirësohen për plotësimin sa më të mirë të mundshëm të nevojave të komunitetit, dhe drafti paketa fiskale.

Grupet që do të konsultohen:

Banorët e qytetit Cërrik dhe të gjithë Njësitë Administrative të Bashkisë Cërrik, përfaqsues të Biznesit, Kryetarët e fshatrave, mësues etj...

Kalendari: Të afishohet pranë zyrave të Nj. Administr-ative, publikohet online në sektorin e njoftimeve të faqes së internetit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak 10 ditë para mbajtjes së takimit.
Pyetje dhe diskutime? Ska
Miratohet me: 20 vota pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim.

Pika 9

Z. Hekuran Kumria, i propozon Këshillit Bashkiak Cërrik të miratojnë "Rritjen e limitit të përdorimit e të ardhurave për vitin 2024" sipas më poshtë:
1- Të rritet limiti i përdorimit të ardhurave të Bashkisë me 10,000,000,00 lekë
2- Të rritet plani i shpenzimeve nga të ardhurat me 10,000,000,00 lekë.
3- Shpenzimet do Alokohen në programin e Sportit për rikonstruksionin e "Sheshit Rekreativ" Shtëmen Cërrik fusha e Sportit, Pjesë e planit të shpenzimeve për investime të miratuara në fillim të vitit) si më poshtë
Shuma: 10,000,000,00 lekë
Pyetje dhe diskutime? Ska
Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim.

Pika 10

Z. Hekuran Kumria propozon për miratimin e Nivelit të pagave të reja që futen në fuqi nga 1 Shtatori 2024 si më poshtë:
A- Pagat e punonjësve civil dhe administrativ të Bashkisë Cërrik bazuar në strukturën Organike e funksionale, bazuar në planin e diplomës dhe përshkrimin e pozicionit të punës të detajuara më poshtë projektit.
B- Pagat për funksionet e deleguara përcaktohen në vendimin nr. 502, datë 1.08.2024.
C- Pagat për punonjësit mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme përcaktohen sipas vendimit 422, datë 26.06.2024.
Ç- Pagat për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, përcaktohen në lidhjen nr. 1 të vendimit nr. 419, datë 26.06.2024. Paga sipas strukturës, bazuar në nivelin, Graden, si dhe shtesat për natyrë të veçant pune.
D- Paga e këshilltarëve do të jetë 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
DH- Paga e Kryepleqëve 10% e pagës së Administrato-rit të Njësisë përkatëse.
E- Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerzore e Juridike dhe Financës për të bërë klasifikimin dhe vlerësimin e çdo vendi pune, bazuar në (programin) organigramën e Bashkisë dhe strukturën e miratuar nga komisioni i Ristrukturimit, sipas kategorisë, klasave, grupit të diplomës dhe pagën për çdo pozicion të përcaktuar në VKM nr. 503, datë 1.08.2024.
Ë- Paga individuale për çdo pozicion pune do të përcaktohet bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë të çdo punonjësi.
G- Efektet Financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij projekti, fillojnë nga 1-Shtatori 2024 dhe përballohen 1- Për nivelin e pagave deri në kufirin minimal, nga fondet e kontigjencës të Qeverisë. 2- Për nivelet

mbi pagën minimale, nga të ardhurat e veta të Bashkisë.
Z. Hekuran Shtoi se bashkëngjitur projektit mbodhe tabela e pagave sipas kategorive.
Pyetje dhe diskutime:
Z. Elton Ibro :- Përse zv/Kryetarët se kanë pagën e njëjtë?
Kishim ndryshime nga punëtorët e thjeshtë e nga drejtorët.
A ka pensionist që marrin rrogë në Bashki?
Z. Hekuran :- Për sa i përket pyetjes së parë për zv/Kryetarët, ne i marim në bazë të punës dhe angazhimit që kanë.
Për sa i përketë pensionistëve di që janë ja 3- puntor që ne i kemi të domosdoshëm dhe që rrole gjinden për aftësin e tyre. Një ndër tyre është Gim Banushi etj.
Z. Qamil Boja :- Më bëhet qejfi që ka ardhur kjo rritje e pagave.
Z. Shyqyri Komami :- Të paktën puntorët e shërbimeve të rriten në maksimale.
Z. Hekuran :- Janë të gjithë në maksimale.
Miratohet me: 20 vota Po
0 vota kundër
0 vota Apstenim.

Pika 11
Z. Filip Aslloni, Drejtor i Arsimit dhe kulturës prezanton projektin për miratimin e zgjatjes së afatit të kontratës për një periudh 3-mujore për Administratorin "Klubi i Futbollit" "TURBINA" me NIPT K72804202B me Adres Cërrik, Elbasan, Z. Gentjan Gjoka i cili zotëron 60% të aksionerve të këtij Klubi. Kjo zgjatje kontrate

bëhet për shkak të pamundësisë për të kaluar vlerën për pagesën e shpenzimeve të klubit që i takon Bashkisë nga zotrimi i 40% të aksionerve.
Pyetje dhe diskutime? Ska
Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim.

Kryesuesi: Duke ju falenderuar për pjesmarrjen, mbledhjen e deklaroj të përfunduar. Në këtë mbledhje u miratuan 11 (njëmbëdhjet) Vendime. Mbledhja përfundoi në orën 16:15 min.

Sekretare e Këshillit Bashkiak
Edlije Aslloni

Ylltmir Laroshi
Erona Gjini
Bujar Bunjaku
Burbuqe Bajo
Pranvera Liçi
Gazmira Trebulli
Anisa Taçi
Xhoaldo Aslloni
Flutura Koxholli
Zeqine Dhepa
Shyqyri Komami
Adriatik Bilali